

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NDIKIMIN E AKTERËVE TË HUAJ NË KOSOVË DHE BASHKËPUNIMIN RAJONAL



Autore:

Dorjeta Rukiqi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:





PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NDIKIMIN E AKTERËVE TË HUAJ NË KOSOVË DHE BASHKËPUNIMIN RAJONAL

Qershor 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	2
Përmbledhje ekzekutive	3
Metodologjia	4
Perceptimet e qytetarëve për akterët e huaj në Kosovë	5
Analiza e të dhënave – korrelacioni midis sigurisë publike/kërcënimeve kombëtare me akterë të huaj	7
Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin rajona.....	11
Perceptimet e qytetarëve mbi ndikimet e vendeve të Ballkanit Perëndimorë në Kosovë.....	11
Analiza e të dhënave – korrelacioni ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Sigurisë Publike/Sigurisë Kombëtare	13
Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin rajonal	14
Rishikimi i realitetit kundrejt perceptimit të qytetarëve	17

TABELA E FIGURAVE

Tabela 1	Sipas mendimit tuaj, cili është ndikimi i këtyre vendeve në Kosovë?	5
Tabela 2	Variablat	8
Tabela 3	Raporti mes ndikimeve të huaja dhe sigurisë publike/kërcënime kombëtare	9
Tabela 4	Raporti ndërmjet ndikimeve të huaja dhe kërcënimeve kombëtare- Analiza e regresionit	10
Tabela 5	Raporti ndërmjet ndikimeve dashamirëse dhe kërcënimeve kombëtare - Analiza e regresionit	10
Tabela 6	Cili është ndikimi i këtyre vendeve ndaj Kosovës?	11
Tabela 7	Sa të sigurt do të ndiheshit të udhëtoni në këto vende?	12
Tabela 8	Raporti ndërmjet Kërcënimeve Kombëtare dhe Ballkanit Perëndimor	13
Tabela 9	Raporti ndërmjet Sigurisë Publike dhe Ballkanit Perëndimor	13
Tabela 10	Raporti ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Sigurisë Publike	14
Tabela 11	Sa e përkrahni bashkëpunimin rajonal, lirinë e lëvizjeve dhe Iniciativën Ballkani i Hapur?	15

HYRJE

Ky raport është rezultat i BSBP 2022, që synon të shqyrtojë perceptimet e qytetarëve në lidhje me ndikimet e huaja në Kosovë dhe bashkëpunimin rajonal.

Raporti përbëhet nga tre kapituj: i) Perceptimi i qytetarëve për ndikimet e huaja; ii) Perceptimi i qytetarëve për bashkëpunimin rajonal; dhe iii) Rishikimi i realitetit kundrejt perceptimit të qytetarëve.

Kapitulli i parë shqyrton perceptimet e qytetarëve për ndikimet e akterëve të huaj në Kosovë. Në kuadër të këtij kapitulli, një nënseksion analizon rezultatet e korrelacioneve ndërmjet perceptimeve të ndikimeve të huaja dhe pikëpamjeve të qytetarëve për sigurinë publike dhe sigurinë kombëtare në Kosovë.

Kapitulli i dytë fokusohet në perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin rajonal. Ajo përfshin dy nënseksione që eksplorojnë perspektivat e qytetarëve për Iniciativën e Ballkanit të Hapur dhe ofron analiza korrelative midis perceptimeve të akterëve rajonalë dhe sigurisë publike, si dhe sigurisë kombëtare.

Kapitulli i tretë shqyrton situata të ndryshme të sigurisë në Kosovë dhe i krahason ato me perceptimet e qytetarëve për ndikimet e huaja dhe bashkëpunimin rajonal.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Perceptimi i përgjithshëm i të anketuarve ndaj vendeve perëndimore siç janë SHBA (91 përqind), Gjermania (90 përqind), Austria (84 përqind) dhe Mbretëria e Bashkuar (83 përqind) është pozitiv. Në anën tjetër, perceptime negative shkojnë ndaj shteteve që nuk e njohin Kosovën, siç janë Rusia (86 përqind), Kina (65 përqind), Spanja (61 përqind) dhe Irani (49 përqind).

Ndikimi pozitiv i akterëve perëndimorë në Kosovë është i dukshëm përmes ndihmës, asistencës dhe mbështetjes së tyre gjatë gjithë procesit të shtetndërtimit të Kosovës. Programet e tyre të bashkëpunimit ndërkombëtar, që e kanë synim promovimin e demokracisë dhe ofrimin e mbështetjes ekonomike dhe financiare, e kanë ndihmuar shumë avancimin e Kosovës si një shtet i ri.

Anasjelltas, perceptimet e ndikimeve keqdashëse përputhen me pengesat e paraqitura nga vende si Rusia, Kina dhe Spanja. Këto kombe kanë penguar përparimin e Kosovës duke penguar pjesëmarrjen e saj në procese vendimtare, duke bllokuar anëtarësimin e saj në organizatat ndërkombëtare, duke refuzuar të njohin pavarësinë e saj dhe duke injoruar institucionet e saj. Këto veprime kanë kontribuar në perceptimet negative ndaj këtyre vendeve në mesin e të anketuarve, duke reflektuar ndikimin e tyre negativ në zhvillimin e Kosovës.

Sa i përket vendeve të rajonit, 90 për qind e të anketuarve e shohin Shqipërinë si me ndikimin më pozitiv, ndërsa Serbia perceptohet si vendi rajonal me ndikimin më negativ.

Për sa i përket bashkëpunimit rajonal, 69 për qind e të anketuarve e mbështesin atë, ndërsa 24 për qind janë kundër. Në mënyrë të ngjashme, 70 për qind e të anketuarve mbështesin lëvizjen e lirë të forcës punëtore dhe mallrave brenda rajonit, ndërsa 24 për qind kanë qëndrim të kundërt. Megjithatë, vetëm 31 për qind e të anketuarve mbështesin të ashtuquajturën Iniciativë Ballkani i Hapur, ndërsa 52 për qind janë kundër saj.

Iniciativa e Ballkanit të Hapur, një përpjekje rajonale për të promovuar bashkëpunimin në Ballkanin Perëndimor, ka shkaktuar reagime të përziara në mesin e opinionit publik në Kosovë. Mungesa e një statuti të qartë të shkruar dhe qëllimet e papërcaktuara kanë shkaktuar konfuzion, ku shumica e shohin këtë iniciativë si një mjet me të cilin Serbia mundohet të konsolidojë dominimin e saj në rajon. Këta faktorë kontribuojnë në dinamikën komplekse dhe pasiguritë që rrethojnë Iniciativën e Ballkanit të Hapur në Kosovë.

Të anketuarit që mbështesin Iniciativën e Ballkanit të Hapur sugjerojnë se ajo përmirëson bashkëpunimin rajonal, vendos lirinë e lëvizjes në rajon, gjeneron punësim dhe nxit zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër, ata që e kundërshtojnë argumentojnë se ajo fuqizon Serbinë, diskriminon pozitën e Kosovës në rajon dhe dobëson ekonominë e Kosovës.

METODOLOGJIA

Të dhënat e anketës për këtë raport janë mbledhur në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), përmes intervistave sy më sy me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. BSBP është projekt rajonal i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe anketa është kryer njëkohësisht në Shqipëri dhe Serbi. Për zbatimin e këtij projekti, QKSS-ja është në partneritet me Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri dhe Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi. Hulumtimi në terren u realizua nga 25 shtatori deri më 2 tetor 2022. Pyetësi i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,136 amvisëri. Faza e parë e mostrimit ishte bazuar sipas ndarjeve administrative të Drejtorive Rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet si në vijim: Ferizajit, Gjakovës, Gjiçanit, Mitrovicës Jugore, Mitrovicës Veriore, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Numri i anketave të kryera në secilin rreth është hartuar proporcionalisht me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda qarkut përkatës bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 në Kosovë. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostra urbane/rural e bazuar në numrin e familjeve në secilën zonë.

Modele të rastësishme u përdorën për të zgjedhur familjet/amvisëritë brenda vendeve të mostruara, ndërsa rastësia brenda familjeve u bazua në metodën e ditëlindjes së ardhshme të të personit të rritur. Të dhënat u verifikuan në kohë reale nëpërmjet koordinatoreve në terren të cilët vizituan një mostër të paracaktuar të familjeve pas përfundimit të anketimit në familjet përkatëse, nëpërmjet kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kryesore; dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzhi i gabimit është 3 përqind me një interval besimi prej 95 përqind.

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR AKTERËT E HUAJ NË KOSOVË

Vendet e Ballkanit Perëndimor përjetuan një periudhë trazirash politike gjatë viteve 1990, e cila përbënte një rrezik të madh për stabilitetin e kontinentit evropian. Shpërbërja e Jugosllavisë dhe lufta e Kosovës në vitin 1999 çuan në sfida të sigurisë, duke nxitur përfshirjen aktive të komunitetit ndërkombëtar në rajon për të adresuar krizën. Ky angazhim i gjerë rezultoi që rajoni i Ballkanit Perëndimor të shndërrohej në një botë multipolare, me akterë të ndryshëm të përfshirë në zhvillimin e tij. Megjithëse Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara luajnë një rol vendimtar në përparimin e rajonit, ata nuk janë akterët e vetëm. Konkretisht, Rusia, Kina, Turqia dhe shtete të tjera gjithashtu marrin pjesë në formësimin e dinamikës së rajonit të Ballkanit Perëndimor. Derisa Rusia dhe Kina destabilizojnë Kosovën duke ushtruar ndikim keqdashës përmes mediave (dezinformata, lajme të rreme) dhe politikës (duke krijuar trazira në mesin e komuniteteve joshumicë në Kosovë), Turqia ka një ndikim ekonomik dhe të sigurisë në Kosovë.

Anketa e BSBP ka ekzaminuar perceptimin e qytetarëve/të anketuarve të Kosovës lidhur me ndikimin e akterëve të ndryshëm. Lidhur me këtë, afërsisht 91 për qind e të anketuarve e konsiderojnë ndikimin e Shteteve të Bashkuara në Kosovë si shumë ose kryesisht pozitiv, duke e bërë atë ndikimin e huaj të perceptuar më së miri në mesin e të anketuarve. Në mënyrë të ngjashme, shumica e pjesëmarrësve kishin gjithashtu pikëpamje shumë ose kryesisht pozitive ndaj Gjermanisë (90 për qind), Mbretërisë së Bashkuar (83 për qind) dhe Austrisë (84 për qind). Turqia, e njohur si një aleate e rëndësishme e Kosovës, renditet e gjashta në mesin e akterëve të huaj të perceptuar pozitivisht, me 68 për qind të të anketuarve që tregojnë një perceptim kryesisht pozitiv. Nga ana tjetër, akterë të caktuar të huaj u perceptuan kryesisht ose shumë negativë nga të anketuarit. Veçanërisht, Rusia mori perceptime negative nga 86 për qind e të anketuarve, e ndjekur nga Kina (65 për qind), Spanja (61 për qind) dhe Irani (49 për qind).

TABELA 1 SIPAS MENDIMIT TUAJ, CILI ËSHTË NDIKIMI I KËTYRE VENDEVE NË KOSOVË?

	Shumë pozitive	Kryesisht pozitive	As pozitive, as negative	Kryesisht negative	Shumë negative	Nuk e di/ Nuk kam mendim
SHBA	75%	16%	3%	3%	2%	1%
Gjermania	55%	35%	5%	2%	1%	2%
Mbretëria e Bashkuar	53%	30%	9%	4%	1%	3%

Perceptimet e qytetarëve për akterët e huaj në Kosovë

Austria	43%	41%	9%	2%	1%	4%
Italia	28%	47%	16%	3%	2%	4%
Turqia	21%	48%	19%	5%	4%	3%
Kroacia	17%	45%	21%	10%	3%	4%
Holanda	13%	37%	27%	12%	4%	7%
Franca	12%	31%	31%	15%	7%	4%
Izraeli	7%	26%	35%	14%	9%	9%
Arabia Saudite	4%	25%	33%	17%	13%	8%
Rusia	2%	4%	5%	12%	74%	3%
Spanja	2%	9%	21%	25%	36%	7%
Irani	2%	8%	31%	22%	27%	10%
Kina	1%	6%	22%	24%	41%	6%
Greqia	1%	5%	19%	23%	46%	6%

Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se të anketuarit në Kosovë kryesisht i perceptojnë vendet perëndimore me ndikime pozitive në shtetin e tyre. Kjo prirje drejt kombeve perëndimore përforcohet më tej nga të dhënat mbështetëse, të cilat tregojnë se 94 për qind e të anketuarve nga Kosova parashikojnë të ardhmen e vendit të tyre në Bashkimin Evropian. Për më tepër, perceptimi pozitiv ndaj Shteteve të Bashkuara (dhe vendeve të tjera perëndimore) mund t'i atribuohet mbështetjes së tyre për Kosovën gjatë vitit 1999. Duke pasur parasysh se procesi i shtet-ndërtimit të Kosovës bazohet në parimet e demokracisë dhe lirisë, ajo është më e prirur të përafrohet dhe të mbështesë vlerat dhe

interesat perëndimore.

Qëndrimet negative ndaj Ruisë dhe Kinës mund t'i atribuohen mbështetjes së tyre të konsiderueshme për Serbinë në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Obstruksionet e Ruisë për anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara, refuzimi për të njohur pavarësinë e saj dhe shfrytëzimi i Kosovës në narrativët mbi konfliktet e ngrira rreth "shteteve fqinje" të saja kontribuojnë në perceptimin negativ.¹ Në mënyrë të ngjashme, Kina shpërfill institucionet e Kosovës dhe e krahason pozicionin e saj me atë të Tajvanit.² Për më tepër, akterë të tjerë, si Spanja, u përpoqën të pengojnë pjesëmarrjen e Kosovës në agjencitë kryesore si Organi i Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike. Ky pengim mund të kishte kufizuar mundësitë e Kosovës për të përfituar nga iniciativat e Bashkimit Evropian, megjithatë përpjekjet e Spanjës ishin të pasuksesshme.³ Një emërues i përbashkët në mesin e të gjithë akterëve që perceptohen negativisht nga të anketuarit është refuzimi i tyre për të njohur pavarësinë e Kosovës. Këto arsye bashkërisht kontribuojnë në një ndjenjë negative mbizotëruese ndaj akterëve specifikë të huaj brenda sferës publike në Kosovë.

Analiza e të dhënave – korrelacioni midis Sigurisë Publike/ Kërclnimeve Kombëtare me Akterë të huaj

Akterët e huaj përdorin qasje të ndryshme dhe shfaqin qëllime të ndryshme kur merren me Kosovën. Siç u diskutua më herët, qytetarët priren të kenë pikëpamje më të favorshme ndaj vendeve perëndimore, ndërsa ndikimet nga rajoni lindor (me përjashtim të Turqisë) në përgjithësi perceptohen si negative. Këto perceptime ndikohen nga ngjarjet historike si shpërbërja e Jugosllavisë dhe lufta e Kosovës në vitin 1999, si dhe sfidat e Kosovës në anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare dhe dinamika e ndërlikuar e procesit të anëtarësimit të saj në BE, të cilat ndikohen nga marrëdhëniet fqinjësore. Në dritën e këtyre faktorëve, ky seksion synon të vlerësojë ndikimin e mundshëm të akterëve të huaj në sigurinë publike dhe nacionale në Kosovë.

Ky studim hulumton faktorë të ndryshëm që kontribuojnë në kuptimin e dinamikave dhe perceptimeve shoqërore. Hulumtimi eksploron variablat 'Kërcënimet Kombëtare', e cila përfshin perceptimet e qytetarëve për një gamë të gjerë kërcënimesh ndaj kombit; 'Siguria Publike', e cila fokusohet në faktorët që ndikojnë në sigurinë publike; 'Ndikimet e huaja', e cila vlerëson ndikimin e vendeve të ndryshme në Kosovë, dhe 'Ndikimet dashamirëse', i cili shqyrton kontributet pozitive të vendeve specifike. Për të fituar njohuri mbi këto variabla, analizat e regresionit dhe korrelacionit u kryen në SPSS, duke ofruar marrëdhënie dhe modele të vlefshme statistikore. Ky seksion synon të zbulojë dinamikën themelore dhe marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet këtyre variablave.

1 Ingimundarson, V. (2022) London School of Economics and political science, London School of Economics. Mund ta gjeni në : <https://www.lse.ac.uk/ideas/Assets/Documents/updates/2022-SU-Valur-RussKosovo.pdf>.

2 Krstinovska, A. (2022) What to expect from China's Kosovo policy, China Observers in Central and Eastern Europe (CHOICE). Mund ta gjeni në : <https://chinaobservers.eu/what-to-expect-from-chinas-kosovo-policy/>.

3 Callet, O. and Bachelier, P. (2021) Can Kosovo be considered as a third country in the meaning of EU law ..., Ghent University. Mund ta gjeni në : <https://www.ugent.be/re/epir/en/news-events/enclosures/kosovocasenote>.

TABELA 2 VARIABLAT

VARIABLAT	SQARIM
Kërcënimet Kombëtare	Një variabël e përbërë që është formuar nga perceptimet e qytetarëve për kërcënimet e ndryshme ndaj kombit, duke përfshirë korrupsionin, krimin e organizuar, trafikun e paligjshëm të armëve, trafikun e drogës, papunësinë, pandeminë COVID-19, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, migrimin dhe ikjen e trurit, krizën ekonomike, ndotjen dhe ngrohja globale, lajmet e rreme, kërcënimet e sigurisë kibernetike, lufta në Ukrainë dhe përshkallëzimi i mundshëm në rajon, rritja e çmimeve të mallrave dhe kriza energjetike.
Siguria publike	Një variabël e përbërë që është formuar nga perceptimet e qytetarëve mbi kërcënimet e ndryshme ndaj sigurisë publike, duke përfshirë ikjen e trurit, kafshët endacake, përdorimin/varësinë nga droga, shërbimet e dobëta të shëndetit publik, ngacmimet seksuale, aksidentet e trafikut, përdorimi i armëve të paligjshme, grabitja e shtëpive/banesave, vrasjet, diskriminimi gjinor, dhuna në familje, mungesa e masave të sigurisë në vendpushimet/zonat përreth, dhuna në shkolla, ndotja, trafikimi i qenieve njerëzore, bullizmi, infrastruktura e dobët dhe mungesa e ndriçimit publik në qytet/fshat/lagje.
Ndikimet e huaja	Një variabël e përbërë që vlerëson ndikimin e vendeve të ndryshme në komb, duke përfshirë SHBA-në, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Austrinë, Italinë, Turqinë, Kroacinë, Holandën, Francën, Izraelin, Arabinë Saudite, Rusinë, Spanjën, Iranin, Kinën dhe Greqinë.
Ndikimet dashakeqëse	Një variabël e përbërë që vlerëson ndikimin negativ dhe kontributet e vendeve të ndryshme në vend, duke përfshirë Rusinë, Kinën, Izraelin, Arabinë Saudite, Iranin dhe Greqinë.
Ndikimet dashamirëse	Një variabël e përbërë që vlerëson ndikimin dhe kontributin pozitiv.

Studimi aktual përdori një analizë korrelacioni për të ekzaminuar marrëdhëniet midis variablave 'Ndikimet e huaja', 'Siguria publike' dhe 'Kërcënimet kombëtare.' Analiza zbuloi një koeficient të moderuar korrelacioni prej 0.64 midis 'Ndikimeve të Huaja' dhe 'Kërcënimeve Kombëtare', siç përcaktohet nga Korrelacioni Pearson në SPSS. Kjo gjetje sugjeron një lidhje të rëndësishme midis këtyre dy variablave, duke treguar se ndryshimet në nivelin e ndikimeve të huaja janë të lidhura mesatarisht me kërcënimet e perceptuara kombëtare. Megjithatë, analiza tregoi një mungesë të korrelacionit midis 'Ndikimeve të Huaja' dhe 'Sigurisë Publike.' Me fjalë të tjera, nuk u vu re asnjë lidhje domethënëse midis shkallës së ndikimeve të huaja dhe perceptimit të sigurisë publike. Këto gjetje theksojnë kompleksitetin e marrëdhënieve midis këtyre variablave, duke treguar se ndikimet e huaja mund të kenë një ndikim më thelbësor në perceptimin e kërcënimeve kombëtare sesa në shqetësimet e sigurisë publike. Megjithatë, nevojiten kërkime të mëtejshme për të eksploruar faktorët dhe dinamikat themelore që kontribuojnë në këto marrëdhënie dhe implikimet e tyre.

TABELA 3 RAPORTI MES NDIKIMEVE TË HUAJA DHE SIGURISË PUBLIKE/ KËRCËNIME KOMBËTARE

	1	2	3
Ndikimet e huaja	-	.048	.064*
Siguria publike		-	.513**
Kërcënimet Kombëtare			-

*. Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.05 .

**. Korrelacioni është i rëndësishëm në nivelin 0.01 .

Studimi përdori më tej një analizë regresioni për të eksploruar marrëdhënien midis 'Ndikimet e Huaja' si variabël e pavarur dhe 'Kërcënimet Kombëtare' si variabël e varur. Analiza zbuloi se niveli i rëndësisë midis këtyre variablave mbetet i ulët, duke sugjeruar një lidhje të dobët. Për më tepër, ndikimi rezultues i 'Ndikimeve të Huaja' në 'Kërcënimet Kombëtare' ishte relativisht i ulët, duke përbërë vetëm 0.03% të variancës së vëzhguar. Kjo tregon se vetëm 'Ndikimet e Huaja' shpjegojnë një pjesë minimale të ndryshimit në perceptimin e kërcënimeve kombëtare. Ajo sugjeron që faktorë të tjerë përtej ndikimeve të huaja mund të luajnë një rol më thelbësor në formësimin e perceptimit të kërcënimeve kombëtare.

TABELA 4 RAPORTI NDËRMJET NDIKIMEVE TË HUAJA DHE KËRCËNIMEVE KOMBËTARE- ANALIZA E REGRESIONIT

R	R katrore	R katrore e rregulluar	Gabimi standard I vlerësimit	Ndryshimi statistikor	Durbin-Watson
.064	.004	.003	6.145	.004	4.610

Note. Variabla e varur: Kërcënimet Kombëtare
Parashikuesit: (Konstant) Ndikimet _ e Huaja

Në analizën e regresionit të kryer në mënyrë specifike midis 'Ndikimeve dashamirëse' dhe 'Kërcënimeve kombëtare' u vu re një nivel i dukshëm rëndësie, duke treguar një ndikim të konsiderueshëm prej 19%. Ky ndikim mund të karakterizohet si i moderuar në të fortë, duke sugjeruar se prania dhe ndikimi i akterëve dashamirës në Kosovë kanë një ndikim të konsiderueshëm në perceptimin e kërcënimeve të sigurisë kombëtare. Ndikimi prej 19% ofron një shpjegim për perceptimin e të anketuarve se siguria e tyre kombëtare është më pak e kërcënuar në praninë e këtyre akterëve të huaj pozitivë. Gjetjet sugjerojnë se me rritjen e pranisë dhe ndikimit të akterëve dashamirës, ka një rënie korresponduese në perceptimin e kërcënimeve të sigurisë kombëtare. Megjithatë, nga ana tjetër, testet e mëtejshme që ekzaminojnë ndikimin e akterëve keqdashës në sigurinë publike dhe kërcënimet kombëtare nuk zbuluan lidhje ose efekte domethënëse të relevancës. Kjo sugjeron që ndikimi i akterëve të huaj negativë ose të dëmshëm nuk ka një ndikim të dukshëm në perceptimin e sigurisë publike ose kërcënimeve kombëtare midis të anketuarve.

TABELA 5 RAPORTI NDËRMJET NDIKIMET DASHAMIRËSE DHE KËRCËNIMEVE KOMBËTARE -ANALIZA E REGRESIONIT

R	R katrore	R katrore e rregulluar	Gabimi standard I vlerësimit	Ndryshimi statistikor	Durbin-Watson
.140	.020	.019	6.097	.020	22.786

Note. Variabla e varur: : Kërcënimet _ kombëtare
Parashikuesit: (Konstant), Influcnat _ dashmirëse

PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR BASHKËPUNIMIN RAJONAL

Perceptimet e qytetarëve mbi ndikimet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Kosovë

Bashkëpunimi i Kosovës me vendet e rajonit ka një rëndësi të madhe në përpjekjet e saj për tu integruar në Bashkimin Evropian dhe vendosjen e marrëdhënieve pozitive fqinjësore. Sipas Raportit të Kosovës të vitit 2022, Kosova mban marrëdhënie miqësore me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi.⁴ Megjithatë, marrëdhëniet me Bosnjën dhe Hercegovinën qëndron e pandryshuar, e karakterizuar me regjim vizash. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ende duke vazhduar përmes dialogut Kosovë-Serbi.

Në përputhje me këto gjetje, të anketuarit në botimin e BSBP 2022 e perceptojnë Shqipërinë si vendin rajonal me ndikimin më pozitiv. 80 për qind e të anketuarve shprehën se ka ndikim shumë ose kryesisht pozitiv. Mali i Zi perceptohet të ketë një ndikim kryesisht pozitiv nga 42 për qind e të anketuarve, ndërsa 35 për qind tregojnë se nuk ka ndikim as pozitiv e as negativ në Kosovë. Megjithatë, mendimet janë të ndara kur bëhet fjalë për ndikimin e Maqedonisë së Veriut, me 37 për qind të të anketuarve që e perceptojnë atë kryesisht si pozitiv dhe me një përqindje të njëjtë deklarojnë as me ndikim pozitiv e as negativ.

Zhvillimi i kufizuar i marrëdhënieve ndërmjet Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës reflektohet potencialisht në përgjigjet e të anketuarve në lidhje me ndikimin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Shumica e të anketuarve (43 përqind) nuk shohin ndikim pozitiv e as negativ të Bosnjës dhe Hercegovinës në Kosovë, ndërsa 33 përqind besojnë se ka një ndikim shumë ose kryesisht negativ. Marrëdhëniet me Serbinë shihen si më komplekset, ku 89 për qind e të anketuarve kanë treguar se ka një ndikim shumë ose kryesisht negativ në Kosovë.

TABELA 6 CILI ËSHTË NDIKIMI I KËTYRE VENDEVE NDAJ KOSOVËS?

	Shumë pozitive	Kryesisht pozitive	As pozitive, as negative	Kryesisht negative	Shumë negative	Nuk e di/ Nuk kam mendim
Shqipëria	46%	34%	10%	5%	3%	2%

⁴ European Commission (2022) Kosovo report 2022, European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations (DG NEAR). Mund ta gjeni në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2022_en.

Mali i Zi	10%	42%	35%	8%	1%	4%
Maqedonia e Veriut	8%	37%	37%	11%	3%	4%
Bosnja dhe Hercegovina	1%	15%	43%	22%	11%	8%
Serbia	1%	4%	4%	6%	83%	2%

a. Sa të sigurt ndiheni kur udhëtoni në vendet e Ballkanit Perëndimor?

Brenda këtij botimi të BSBP, të anketuarit u pyetën në lidhje me ndjenjën e tyre të sigurisë kur udhëtonin në vende të ndryshme të rajonit. Rezultatet tregojnë se afërsisht 89 për qind e të anketuarve ndihen të sigurt ose deri diku të sigurt kur udhëtojnë në Shqipëri. Në anën tjetër, të anketuarit shprehën ndjenjën më të vogël të sigurisë kur udhëtojnë në Serbi, me 69 përqind që ndihen të pasigurt dhe vetëm 38 përqind ndihen të sigurt ose disi të sigurt. Për më tepër, të anketuarit raportuan se ndiheshin të sigurt ose disi të sigurt kur udhëtojnë në Malin e Zi (89 përqind) dhe Maqedoninë e Veriut (87 përqind). Sa i përket udhëtimit në Bosnje dhe Hercegovinë (BeH), të anketuarit shfaqën mendime të ndryshme. Dyzet përqind e të anketuarve treguan se ndihen të pasigurt për të udhëtuar në BeH, ndërsa 30 përqind ndihen disi të sigurt dhe 20 përqind ndihen të sigurt për të udhëtuar në BeH.

TABELA 7 SA TË SIGURT DO TË NDIHESHIT TË UDHËTONI NË KËTO VENDE?

	I sigurt	Deri diku i/e sigurt	I/e pasigurt	Nuk e di/ Nuk kam mendim
Shqipëria	66%	23%	10%	1%
Mali i Zi	58%	31%	7%	4%
Maqedonia e Veriut	53%	34%	9%	4%
Bosnja dhe Hercegovina	14%	14%	69%	3%
Serbia	20%	30%	40%	10%

Analiza e të dhënave – korrelacioni ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe Sigurisë Publike/Sigurisë Kombëtare

Ky seksion paraqet një analizë të të dhënave që synon të shpjegojë ndikimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) në sigurinë publike dhe kërcënimet kombëtare në Kosovë. Me kalimin e kohës, këto ndërveprime kanë pësuar ndryshime për shkak të afërsisë gjeografike të vendit. Megjithëse Kosova përpiqet të forcojë marrëdhëniet e saj me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, ajo vazhdon të përballet me sfida në marrëdhëniet e saja me Serbinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Në këtë analizë, variabla "Ballkani Perëndimor" përfshin Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Variablat me interes, përkatësisht Siguria Publike dhe Kërcënimet Kombëtare, mbeten konsistente siç përshkruhen në Tabelën 2.

TABELA 8 RAPORTI NDËRMJET KËRCËNIMEVE KOMBËTARE DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

	1	2
Kërcënimet Kombëtare	-	.086*
Ballkani Perëndimor		-

*. Korelacioni është signifikant në nivelin 0.05.

**. Korelacioni është signifikant në nivelin 0.01.

TABELA 9 RAPORTI NDËRMJET SIGURISË PUBLIKE DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

	1	2
Ballkani Perëndimor	-	.078*
Siguria Publike		-

*. Korelacioni është signifikant në nivelin 0.05.

**. Korelacioni është signifikant në nivelin 0.01.

Analiza na tregon për një shkallë të moderuar korrelacioni midis rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Kërcënimeve Kombëtare (0,086) (Tabela 8) dhe Sigurisë Publike (0,078) (Tabela 9). Këto gjetje sugjerojnë për një marrëdhënie modeste midis rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe perceptimit si të asaj të kërcënimeve kombëtare dhe sigurisë publike. Koeficientet e korrelacionit tregojnë një lidhje pozitive, duke treguar se me rritjen e ndikimit ose pranisë së rajonit të Ballkanit Perëndimor, ka një tendencë të lehtë për të prekur perceptimet si për kërcënimet kombëtare ashtu edhe për sigurinë publike. Megjithëse

madhësia e korrelacioneve nuk është thelbësore, ato nënkuptojnë se rajoni i Ballkanit Perëndimor mund të ketë njëfarë ndikimi në perceptimet e këtyre aspekteve të lidhura me sigurinë.

TABELA 10 RAPORTI NDËRMJET BALLKANIT PERËNDIMOR DHE SIGURISË PUBLIKE

R	R katrore	R katrore e rregulluar	Gabimi standard I vlerësimit	Ndryshimi statistikor	Durbin-Watson
.006	.005	.006	6.888	.009	1.538

Note. Variabla e varur: Ballkani Perëndimor
Parashikuesit: (Konstant), Siguria Publike

Për më tepër, rezultatet e analizës së regresionit nxjerrin në pah ndikimin e dukshëm të mbajtjes së marrëdhënieve pozitive me vendet e Ballkanit Perëndimor në sigurinë publike në Kosovë. Konkretisht, analiza tregon se faktori i Ballkanit Perëndimor ndikon në perceptimin e sigurisë publike me gjashtë për qind. Ndonëse ky efekt mund të konsiderohet relativisht modest për sa i përket rëndësisë statistikore, e thekson rëndësinë e marrëdhënieve fqinjësore në formësimin e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë. Këto gjetje nënvizojnë rëndësinë e nxitjes së marrëdhënieve pozitive me vendet fqinje si një faktor kontribues në rritjen e ndjenjës së përgjithshme të sigurisë publike dhe sigurisë për popullatën.

Perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin rajonal

Iniciativa Ballkanit i Hapur, e cila u shfaq brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe ngushtë përputhet me parimet e Procesit të Berlinit, është një rrugëtim ekonomik. Fillimisht e udhëhequr dhe e mbështetur nga Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ajo u përball me sfida për të mbledhur mbështetje më të gjerë brenda Ballkanit Perëndimor. Aktualisht, Mali i Zi ndodhet në një udhëkryq në lidhje se atë i bashkëngjitet kësaj iniciative. Në veçanti, qeveria e Kosovës e refuzon me vendosmëri iniciativën e Ballkanit të Hapur, pra është kundër pjesëmarrjes në kësaj lloji bashkëpunimi jashtë kornizës së Procesit të Berlinit.

Në të njëjtën mënyrë, të anketuarit që shprehën mungesën e mbështetjes për iniciativën e Ballkanit të Hapur parashtruan argumente duke theksuar se ajo i jep një ndikim të shtuar Serbisë, minimizon pozitën e Kosovës në rajon dhe dobëson ekonominë e Kosovës. Nga ana tjetër, të anketuarit që mbështesin iniciativën e Ballkanit të Hapur pohojnë se ajo rrit bashkëpunimin rajonal, lehtëson lirinë e lëvizjes në të gjithë rajonin, stimulon krijimin e

vendeve të reja të punës dhe nxit zhvillimin ekonomik.

Bashkëpunimi rajonal brenda Ballkanit Perëndimor, që synon adresimin e sfidave të përbashkëta politike dhe ekonomike, luan një rol vendimtar në rrugën e rajonit drejt anëtarësimit dhe stabilizimit në BE.⁵ Besimi brenda BE-së është se nxitja e bashkëpunimit ekonomik do të nxisë unitet më të madh, duke çuar në një të ardhme të përbashkët dhe pajtim midis kombeve.⁶ Në mënyrë të pamohueshme, rajoni kërkon zhvillim ekonomik; megjithatë, dhe se mbështetja vetëm përmes zgjidhjeve ekonomike të zgjidhjen problemet politike mund të jetë çështje tepër e thjeshtëzuar.

Bazuar në rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për zhvillimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor, BSBP 2022 ka matur perceptimet e qytetarëve në lidhje me këtë temë. Në këtë drejtim, shumica e të anketuarve në sondazhin BSBP 2022 nuk kanë një pikëpamje negative për bashkëpunimin rajonal në kontekste të ndryshme. Në fakt, 69 për qind e të anketuarve kanë shprehur mbështetje për bashkëpunimin rajonal, ndërsa 24 për qind janë shprehur kundër.

Kur u pyetën në mënyrë specifike për mbështetjen e lirisë së lëvizjes, shkëmbimin e informacionit dhe krijimin e tregut të përbashkët për mallrat dhe fuqinë punëtore, 70 për qind e të anketuarve shprehën mbështetjen e tyre, ndërsa 24 për qind kishin një qëndrim të kundërt. Megjithatë, kur u pyetën për mbështetjen e tyre për konceptin e "Ballkani i Hapur", i cili përmbledh parimet e bashkëpunimit rajonal, 52 për qind e të anketuarve treguan mungesën e mbështetjes së tyre, ndërsa 31 për qind shprehën mbështetjen e tyre. Përafërsisht 17 për qind e të anketuarve nuk kanë dhënë opinion për çështjen e Ballkanit të Hapur.

TABELA 11 A E PËRKRAHNI BASHKËPUNIMIN RAJONAL, LIRINË E LËVIZJEVE DHE INICIATIVËN BALLKANI I HAPUR?

	Po	Jo	Nuk e di/ Nuk kam mendim
A e përkrahni bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor?	69%	24%	7%
A e mbështesni lëvizjen e lirë, shkëmbimin e informacionit dhe tregun e përbashkët të mallrave dhe fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor?	70%	24%	6%
A e mbështesni idenë e ashtuquajtur "Ballkani i hapur"?	31%	52%	17%

⁵ European Commission (no date) Regional cooperation, European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations (DG NEAR). European Commission . Mund ta gjeni në: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/policy-highlights/regional-cooperation_en#:~:text=Regional%20co%2Doperation%20is%20an,%2Dborder%20criminal%20activities%2C%20etc.

⁶ European Union (no date) Regional cooperation: Webalkans: EU projects in the western balkans, WeBalkans. European Union . Mund ta gjeni në: <https://webalkans.eu/en/themes/regional-cooperation/>.

Iniciativa "Ballkani i Hapur" është subjekt i interpretimeve të ndryshme, edhe vetë përbrenda arenës ndërkombëtare. Ndonëse qeveria e Kosovës e kundërshton nismën, duke përmendur shqetësimet për ndikimin e saj në pavarësinë, sovranitetin dhe faktorë të tjerë, qeveritë e Serbisë dhe Shqipërisë e konsiderojnë atë si një zgjidhje ekonomike shumë të dobishme. Analisti ballkanik Edward P. Joseph, në një intervistë, paralajmëroi se iniciativa "Ballkani i Hapur" mund të ketë implikime të rrezikshme për Ballkanin Perëndimor dhe të kontribuojë në idenë e prirjes hegjemoniste të Serbisë në rajon.⁷ Nga ana tjetër, Shtetet e Bashkuara e mbështesin plotësisht iniciativën, duke e përkrahur konceptin që del nga rajoni, duke këmbëngulur se nisma është e suksesshme vetëm nëse i bashkohen të gjitha vendet e BP-së. US Ambasadori i SHBA-së në Serbi, Christopher Hill, pohon se iniciativa "Ballkani i Hapur" nuk ka pasoja negative për rajonin.⁸ Megjithatë, rajoni mbetet i ndarë në qëndrimin e tij ndaj kësaj iniciative.

7 Elezi, E. (2022) 'open balkan' could worsen political problems in region – DW – 08/18/2022, dw.com. Deutsche Welle. Mund ta gjeni në: <https://www.dw.com/en/open-balkan-initiative-risks-aggravating-political-problems-in-the-region/a-62834261>.

8 CorD (2022) Ambassador Christopher Hill: Open Balkans a necessary process, CorD Magazine. CorD Magazine. Mund ta gjeni në: <https://cordmagazine.com/news/ambassador-christopher-hill-open-balkans-a-necessary-process/>.

RISHIKIMI I REALITETIT KUNDREJT PERCEPTIMEVE TË QYTETARËVE

Ndikimet e huaja përgjithësisht perceptohen si pozitive kur ato rezultojnë në përfitime të ndërsjella si për ndikuesin ashtu edhe për shtetin e synuar.⁹ Anasjelltas, një ndikim konsiderohet keqdashës kur akteri fiton në kurriz të vendit të synuar.¹⁰ Në raste të tilla, shteti ndikues mund të imponojë sistemin e tij politik ose ekonomik pa kërkuar të avancuar interesat e vendit të synuar. Realiteti pasqyron ndikimin pozitiv të akterëve perëndimorë në Kosovë, pasi ata kanë ofruar ndihmë dhe asistencë gjatë gjithë procesit të shtetndërtimit të saj por dhe më gjerë. Programet e bashkëpunimit ndërkombëtar të akterëve perëndimorë, që kanë kontribuar në promovimin e demokracisë në Kosovë dhe kanë ofruar mbështetje ekonomike dhe financiare, e kanë lehtësuar përparimin e Kosovës si shtet i ri.

Ky realitet përputhet me perceptimet pozitive të shprehura nga të anketuarit ndaj Shteteve të Bashkuara dhe disa vendeve të Bashkimit Evropian (BE). Shumë vende të BE-së kanë treguar mbështetje për Kosovën duke njohur pavarësinë e saj.¹¹ Shpat Balaj, hulumtues në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) argumenton se qytetarët në Kosovë prirën t'i perceptojnë vendet që e kanë njohur Kosovën si ndikime pozitive, ndërsa ato që nuk e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës shihen negativisht.¹² Është e rëndësishme të theksohet se qytetarët mund të mos kenë domosdoshmërisht njohuri të thella për proceset e tjera politike. Ndarja ndërmjet ndikimeve dashamirëse dhe keqdashëse në Kosovë shpesh bazohet në faktorë historikë.¹³

Anasjelltas, perceptimet e të anketuarve përputhen me realitetin e ndikimeve keqdashëse të perceptuara. Shtetet si Rusia, Kina dhe Spanja e kanë penguar përparimin e Kosovës duke penguar pjesëmarrjen e saj në proceset kyçe. Veprimet e tyre, duke përfshirë bllokimin e anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, refuzimin për të njohur pavarësinë e saj dhe shpërfilljen e institucioneve të saj, kanë ndikuar dukshëm në perceptimet e qytetarëve dhe kanë kontribuar në cikle të stagnimit në zhvillimin e Kosovës.

Shtetet si Rusia dhe Kina, të cilat mbajnë bashkëpunim të ngushtë me Serbinë,¹⁴ paraqesin sfida për të shtrirë ndikimin e tyre në Kosovë. Ndonëse ka dëshmi ekzistuese të qëndrimit të Rusisë ndaj Kosovës dhe anasjelltas, në anën tjetër ka informacione të kufizuar në lidhje me ndikimin kinez në Kosovë.¹⁵ Ndikimi kinez në mënyrë indirekte arrin në Kosovë përmes kanaleve dytësore, kryesisht përmes produkteve të eksportuara

9 Vllasi, E. (2020) Ndikimi Rus në Kosovë: Nën Hijet E Mitit dhe realitetit, QKSS. Mund ta gjeni në: <https://qkss.org/al/publikimet/ndikimi-rus-ne-kosove-nen-hijet-e-mitit-dhe-realitit>.

10 Ibid.

11 Intervistë me hulumtuesen e QKSS-së Adelina Hasani, 2023

12 Intervistë me hulumtuesin e QKSS-së Shpat Balaj, 2023

13 Ibid.

14 Intervistë me hulumtuesen e QKSS-së Adelina Hasani, 2023

15 Ibid.

nga Kina në Maqedoninë e Veriut dhe më pas në Kosovë.¹⁶ Rastet e ndikimit kinez që mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës janë të njohura vetëm për shërbimet e inteligjencës së Kosovës dhe nuk shfaqen për publikun. Perceptimet e qytetarëve përputhen me realitetin se nuk ka interes publik për bashkëpunim ndërmjet Kosovës dhe Rusisë apo Kinës, dhe anasjelltas.

Po kështu, në kontekstin e bashkëpunimit rajonal, shtetet që nuk e njohin Kosovën, si Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, perceptohen vërtet më negativisht. Nga ana tjetër, shtete si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut mbajnë marrëdhënie diplomatike me Kosovën dhe e njohin statusin e saj të shtetit të pavarur. Ndërsa me Shqipërinë krijohet një lidhje edhe më emocionale, e nxitur nga faktorë historikë, kulturorë dhe gjuhësorë.¹⁷

Nisma rajonale që synon rritjen e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor ka gjeneruar sinjale të përziara në mesin e publikut në Kosovë. Duket se ka një korrelacion ndërmjet perceptimeve të qytetarëve dhe realitetit në terren. Ndonëse bashkëpunimi rajonal mund të nxisë potencialisht aktivitete ekonomike në një shkallë më të gjerë, Iniciativa Ballkani i Hapur ka krijuar konfuzion për shkak të mungesës së një statuti të shkruar dhe objektivave të paqarta.¹⁸ Në Kosovë, publiku shpesh e interpreton këtë iniciativë si pjesë e projektit të Serbisë për të forcuar hegjemoninë e saj në rajon.¹⁹ Për më tepër, meqenëse Iniciativa Ballkani i Hapur përputhet me Procesin e Berlinit, lindin pyetje në lidhje me nevojën dhe qëllimin e saj.

Si përfundim, ky studim mbështetet në një metodologji sasiore, e cila kufizon eksplorimin se pse individët kanë opinione specifike. Megjithatë, duke analizuar trendet dhe temat mbizotëruese në Kosovë, ne fitojmë një kuptim më të mirë të faktorëve që ndikojnë në perceptimet e qytetarëve. Perceptimet e shqyrtuara në këtë raport janë të ndërthurura ngushtë me kontekstin historik dhe politik të Kosovës.

16 Avdimetaj, T. and Ilazi, R. (2021) Beyond Economic Considerations: New frontiers of Chinese influence in the western balkans, QKSS. Mund ta gjeni në : <https://qkss.org/al/publikimet/beyond-economic-considerations-new-frontiers-of-chinese-influence-in-the-western-balkans/>.

17 Zemzadja, E. (2020) An overview of the relations between Albania, Kosovo and Serbia, FOMOSO. A Mund ta gjeni në : <https://www.fomoso.org/en/mosopedia/background-knowledge/an-overview-of-the-relations-between-albania-kosovo-and-serbia/>.

18 Intervistë me hulumtuesin e QKSS-së Shpat Balaj, 2023

19 Ibid.

Katalogimi në botim **(CIP)**


Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

327(047)

Rukiqi, Dorjeta

Perceptimet e qytetarëve për ndikimin e akterëve të huaj në Kosovë dhe bashkëpunimin rajonal / Dorjeta Rukiqi. - Prishtinë : QKSS, 2023. - 19 f. : ilustr. ; 24 cm.

ISBN 978-9951-799-97-3



ISBN 978-9951-799-97-3



9 789951 799973